REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. _____ Prot. Maliq, më 22.05.2025

PROJEKT VENDIM - Nr 9

"PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR TË BASHKISË MALIQ"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "*Per vetëqeverisjen vendore*", Ligjit 57/2020 "*Për Pyjet*", Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007: "Për fondin kullosor" i ndryshuar, Ligji Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 398 datë 13.05.2020 "*Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, date 08.06.2016, te Këshillit te Ministrave, Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", VKM nr.1080,dt.22.12.2010 "*Per rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve*", të ligjit nr. 45/2016 neni 9 dhe 10, "Për vullnetarizmin", Ligji Nr. 152, datë 21.12. 2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", me propozim të kryetarit të Bashkisë,

I propozojmë Këshillit të Bashkisë :

1. Të miratojë planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në Fondin Pyjor/Kullosor të Bashkisë Maliq.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve, Agjencia e Shërbimeve Publike, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave.
3. Ky projekt-vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

Konceptoi	P. Theodhosi		Di. 22/05/2025
Kontrolloi	K.Brako		Di. 22.05.2025
Pranoi	J.Sulo		Di. 22.05.2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE ASETEVE
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Maliq, më 22.05.2025

RELACION

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR TË BASHKISË MALIQ"

Hartimi i planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota.

Me transferimin e fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 *"Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike..."* i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 398 datë 13.05.2020 *"Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave"* Bashkisë i lindin detyrimet ligjore për menaxhimin dhe kontrollin e fondit pyjor dhe kullosor që ka në pronësi. Në zbatim të ligjit 57/2020 "Për Pyjet" struktura menaxhuese e fondit pyjor dhe kullosor në Bashki në zbatim të Nenit 17, pika 1, germa b, *"Strukturat e organeve të shërbimit pyjor Mbledh të dhëna për zhvillimin e pyjeve publike dhe private, përgjigjet për ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor dhe mban të dhëna të sëmundjeve, të dëmtuesve dhe të zjarreve në pyjet e bashkisë, e ato private, brenda territorit administrativ të bashkisë"*. Ky plan masash është hartuar nga Struktura e Pyjeve dhe Kullotave në Bashki çdo vit, është miratuar nga titullari i Bashkisë dhe ju është dërguar për bashkëpunim dhe koordinim dhe institucioneve të tjera si Zjarrfikësja Maliq, Prefektura, etj. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri 57/2020 "Për Pyjet", Neni 30, pika 4, gërmat: b) "struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, çdo vit hartojnë planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar në territorin e tyre... c) plani për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar miratohet nga këshilli bashkiak çdo viti. Bashkitë koordinojnë këtë plan me detyrimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, për të siguruar funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre.

Bashkia Maliq përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Libonik, Gorë, Mogliçë, Vreshtas, Pirg, Pojan. Bashkia Maliq është përgjegjëse për administrimit e fondit pyjor dhe kullosor sipas legjislacionit në fuqi. Bashkia e Maliqit sipas planeve të reja të menaxhimit ka një fond prej 32536.55 ha pyje dhe kullota. Sipërfaqja e madhe e kësaj pasurie , rëndësia e saj por edhe shpërndarja e madhe bën që ti kushtohet një rëndësi e madhe administrimit dhe mbrojtjes nga zjarri. Zjarret në pyje në pesë vitet e fundit paraqesin një problem serioz për pyjet në Bashkinë Maliq pavarësisht se situata ka qenë e menaxhueshme dhe është ndërhyrë nga strukturat përkatëse në kohë mjaft të shpejtë duke ndaluar përhapjen pa

shkaktuar dëme të mëdha. Për këtë flasin vetë shifrat të cilat për periudhën 2021-2025 rezultojnë të jenë djegur rreth **185 ha** pyje e kullota por 90 % e kësaj sipërfaqe të djegur është nga një rast i vetëm, rast i cili ka qenë zjarri më serioz në këto 10 vitet e fundit në fondin pyjor – kullosor të Bashkisë Maliq.

Ky plan masash përveç se një plan masash për të ndihmuar në planifikimin dhe organizimin e strukturave për menaxhimin e zjarreve është edhe një udhëzues i mirë për marrjen e informacionit të nevojshëm mbi këtë fenomen por edhe një manual praktik mbi metodat e ndryshme për menaxhimin e situatave të zjarreve dhe shuarjen e tyre, duke bërë një përshkrim tepër të detajuar që nga shkaqet e rënies së zjarreve, klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota, faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve në pyje si floji i bimësisë, topografia, stina, etj. Masat për parandalimin e zjarreve si masat përgatitore, dhe masat direkt me metodat e ndryshme të shuarjes së zjarreve si shuarje me tokë, shuarje me ujë, luftimi i zjarrit me zjarr, shuarja nga ajri, shuarja me kimikate, etj.

Gjithashtu jep një informacion të nevojshëm për hapat që duhet të ndërmeren për njoftimin e strukturave përkatëse të emergjencave civile në momentin e zbulimit të një zjarri.

I kërkojmë Këshillit të Bashkisë Maliq miratimin e këtij plani masash për organizimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025.

Konceptoi	P. Theodhosi		Di. 21/05/2025
Kontrolloi	K. Brako		Di. 21/05/2025
Pranoi	I.Solo		Di. 21/05/2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE ASETEVE
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

MBROJTJA E PYJEVE NGA ZJARRI

(Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor)



Bashkia Maliq , 2025

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçe Tel. 0861 2 2026

Përmbajtja

1. Hyrje 3
2. Shkaqet e rënies së zjarreve 11
3. Klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota 12
4. Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve ne pyje. 14
5. Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota 15
6. Veprimet kryesore gjatë zbulimit të zjarrit në pyje/kullota. 20
7. Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor. 21

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

1.Hyrje

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" neni 27, neni 64, Urdhrit të Kryeministrit me nr.127, date 16.09.2015 "*Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të Strategjisë Ndër sektoriale për Decentralizimin dhe qeverisjen Vendore*" , VKM nr.1080,dt.22.12.2010 "*Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve*", në zbatim VKM nr.433, dt. 08.06.2016 "*për transferimin në Pronësi të Bashkisë Maliq të pyjeve dhe kullotave*", VKM 398 datë 13.05.2020 , Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 08.06.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe Kullotave*", dhe në zbatim të Ligjit Nr.57/2020 "*Për Pyjet*" neni116/ 17 Përgjegjësitë e strukturave vendore përgjegjës për Pyjet.

Bashkia Maliq përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Libonik, Gorë, Moglicë, Vreshtas, Pirg, Pojan. Bashkia Maliq është përgjegjëse për administrimit e fondit pyjor dhe kullosor sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkia e Maliqit sipas planeve të reja të menaxhimit ka një fond prej 32536.55 ha pyje dhe kullota , të ndara sipas përdorimit të territorit :

Pyll	20270.39
Kullota / Livadhe	4540.519
Shkurre	6660.67
Eroduar / Erozion / Gurore	1013.53
Urbane / Jo Pyjore	32.17
Ujore	19.24

Tabela më poshtë jep të dhënat mbi këto sipërfaqe për secilën Ekonomi Pyjore të Bashkisë Maliq sipas planeve të menaxhimit të hartuar në vitin 2021:

Nr.	Ekonomia Pyjore	Sip. Tot. / ha	Pyje dhe shkurre / ha	Kullota dhe livadhe / ha
1	EP Maliq - Lozhan	5875.58	5540.10	220.69
2	EP Mesmal	3053.64	2519.17	529.39
3	EP Moglicë	6311.63	4590.3	1195.66
4	EP Pirg – Moçan	6239	5861.41	158.69
	EP Bofje Dushar	3902.65	3281.34	460.28
	EP Zëmblak – Mali i Thatë	2713.87	1783.12	923.27
	EP Strelcë	4440.18	3355.62	1052.52
	Totale	**32536.55**	**26886.06**	**4540.5**

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Harta e Pyje/kullota Bashkia Maliq sipas Ekonomive Pyjore.

Harta e Infrastruktures
EP Maliq-Lozhan
Bashkia Maliq



Plani i Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave
Janar 2021

Bashkia Maliq
EP Maliq-Lozhan

1:25,000

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçe Tel. 0861 2 2026

Harta e Infrastruktures
EP Mesmal
Bashkia Maliq



Plani i Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave
Janar 2021

Bashkia Maliq
EP Mesmal



1:25,000

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Harta e Infrastruktures
EP Moglicë
Bashkia Maliq



Plani i Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave
Janar 2021

Bashkia Maliq
EP Moglicë



Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Harta e Infrastruktures
EP Pirg-Mocan
Bashkia Maliq



Plani i Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave
Shkurt 2021

Bashkia Maliq
EP Pirg-Mocan





1:25,000

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026


Harta e Infrastruktures, Bafje e Dusharit
Bashkia Maliq

Plani i Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave
Dhjetor 2020



Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçe Tel. 0861 2 2026

Harta e Infrastruktures
EP Zemblak-Mali I Thatë
Bashkia Maliq



Plani I Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave
Janar 2021

Bashkia Maliq
EP Zemblak-Mali I Thatë



N

1:25,000

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Harta e Infrastruktures
EP Strelcë
Bashkia Maliq



Plani i Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave
Janar 2021



Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Sipërfaqja e madhe e kësaj pasurie , rëndësia e saj por edhe shpërndarja e madhe bën që ti kushtohet një rëndësi e madhe administrimit dhe mbrojtjes nga zjarri.

Zjarret në pyje në pesë vitet e fundit paraqesin një problem serioz për pyjet në Bashkinë Maliq pavarësisht se situata ka qenë e menaxhueshme dhe në kohë mjaft të shpejtë duke ndaluar përhapjen pa shkaktuar dëme të mëdha.

Për këtë flasin vetë shifrat të cilat për periudhën 2021-2025 rezultojnë të jenë djegur rreth **185 ha** pyje e kullota por 90 % e kësaj sipërfaqe të djegur është nga një rast i vetëm, rast i cili ka qenë zjarri më serioz në këto 10 vitet e fundit në fondin pyjor – kullosor të Bashkisë Maliq. Dëmet e këtyre zjarreve kapin vlera të konsiderueshme, kosto këto që përfshijnë dëmet direkt si edhe kostot për të riparuar pasojat e zjarreve. Përveç dëmit shumë të madh ekonomik, që mund të shprehet në të holla, dëmi i shkaktuar në biocenozën e pyllit , pra dëmi ekologjik, është gjithashtu shumë i madh dhe nuk mund të shprehet dot në mënyrë financiare.

2.Shkaqet e rënies së zjarreve.

Arsyet e rënies së zjarreve janë nga më të ndryshmet , por në bazë të përvojave dhe njohurive të deritanishme në 99% të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu (direkt ose indirekt). Rrufeja apo vetëndezja e pyjeve kap vetëm 1% të rasteve. Rënia e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu ndodh nga pakujdesia , padituria , piromania si sëmundje apo qëllim i pastër. Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria , përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojnë në pyje apo kullota të cilët kryejnë punime operacionale në këto zona. Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e hershme kur vegjetacioni barishtor nga viti i kaluar është i thatë dhe vegjetacioni i ri akoma nuk ka filluar. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale , gjuetarët, fermerët apo edhe turistët.

Zjarret e qëllimshme bëhen me qëllim që të zgjerojnë tokën e punueshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet , ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik , për përfitim dru të lire për dru zjarri apo ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale etj.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

3. Klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota.

Sipas llojeve të zjarreve në pyje mund ti specifikojmë në:

- Zjarr nëntokësor ose nën sipërfaqësor





- Zjarr sipërfaqësor ose pranë nëntokës
- Zjarr në kurorat e drurëve
- Zjarr i përgjithshëm ose i kombinuar Më i

përhapur tek ne janë tre rastet e fundit .

Zjarri sipërfaqësor është zjarri në të cilin djegia aktive zhvillohet në sipërfaqe të tokës dhe digjet përgjithësisht biimësi pranë tokës në sipërfaqe si bar , filiza, shkurre etj. Në vartësi të kushteve dhe pranisë së erës flakët e zjarrit mund të arrijnë deri në 2m. Në rajonet e rrafshëta djegia intensive zakonisht ndjek buzët e zjarrit, ndërsa në zonat kodrinore-malore ajo zhvillohet në ballin e zjarrit. Shpejtësia e përhapjes së këtij zjarri (pa erë te fortë) mund të arrijë deri në 2.5 km/h.





Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Zjarri në kurorat e drurëve është një zjarr që ndodh vetëm në kulm apo kurorë të drurëve. Ky lloj zjarri mund të jetë fillesa e një zjarri të kombinuar për shkak të kushteve specifike të djegies gjatë këtyre zjarreve , shpejtësia e përhapjes arrin deri në 20km/h.



Zjarri i përgjithshëm ose i kombinuar përfshin djegien sipërfaqësore si edhe si edhe atë të kurorave . Shkalla e përhapjes së këtyre zjarreve në vartësi të terrenit , llojit të drurëve si edhe shpejtësisë së erës mund të arrijë deri në 20 km/h. Vetë përhapja e zjarrit zakonisht zhvillohet në tre faza , faza fillestare, kërcënimi i zjarrit dhe faza e qetësimit.



Zjarrfikësit dhe jo vetëm, duhet të njohin mirë mënyrën dhe fazat e përhapjes së zjarrit në mënyrë që të shmangin rrezikun të gjenden mes dy zjarreve në momentin që ndodh kërcimi i zjarrit dhe kështu vihen nën kërcënim jetët e tyre.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

4. Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve ne pyje.

Më të rëndësishmit janë.

-Lloji i bimësisë

-Topografia

-Stina vjetore

-Karakteristikat klimaterike

-Komunikacioni

Lloji i bimësisë është një nga faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e rrezikut nga zjarret. Kështu pyjet halorë ndizen më lehtë se ato gjetherënës. Drurët driteëdashës janë më të rrezikuar kjo për shkak se përbërja e pyllit me këto lloje drurësh është më i rrallë. Kështu llojet e bimëve që ndizen lehtë dhe e mbështesin fuqimisht djegien quhen specie bimore " profibe" (pishë , bredh, etj).

Topografia apo relievi i terrenit , së bashku me llojin e tokës luan një rol të rëndësishëm në shkallën e ndezshmërisë të materialit djegës. Në përgjithësi në terrenet të cilët kanë reliev të fortë me orientim nga jugu është lehtësisht më i ndezshëm se ai i orientuar nga veriu. Kjo edhe për vetë faktin e bimësisë që rritet në të.

Stinët me karakteristikat e tyre ndikojnë në ndezshmërinë e pyjeve. Vera me temperatura të larta të ajrit (tek ne rreth 40°) dhe periudha të gjata pa shi e rritin shkallën e ndezshmërise në pyje/kullota. Në këtë periudhë bari thahet , lagështia e tokës zvogëlohet në mënyrë drastike dhe përbën rrezik për zjarr. Kështu kjo periudhë quhet " periudhë kritike e vitit për shfaqjen e zjarreve në hapësirë të hapur". Edhe gjatë periudhës së dimrit për shkak të temperaturave shumë të ulëta kryesisht kur dimri është i thatë , për shkak të lagështisë së ulët të tokës , materiali djegës mund të ndizet lehtësisht. Klima në rajonin tonë si një klimë mesdhetare është favorizuese për zjarret si në hapësira të hapura ashtu edhe në zonat e pyjeve.

Ashtu siç kemi vënë re , shkaku kryesor i zjarreve (me apo pa qëllim) është njeriu. Hapja e rrugëve në zonat e pyjeve apo në afërsi të tyre përdorimi për piknik, rekreacion mbledhjen e produkteve të ndërmjetme pyjore përbën rrezik për zjarr. Por nga ana tjetër pavarësisht efektit negativ , është edhe ai pozitiv i cili mundëson një kontroll më të mirë të zonës apo qasje më të shpejtë të zjarrfikësve dhe automjeteve në rast zjarri.

Adresa: Bulevardi "Rina", Maliq, Korçë Tel. 0863 2 2026

5. Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarreve sipas kohës kur ndërmerren dhe me çfarë qëllimi , ndahen në :

a. Masa preventive
b. Masa përgatitore
c. Masa direkt

Janë masa mbrojtje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Kjo për shkak se njeriu është shkaktar i tyre në 99% të rasteve edhe këto masa janë të përqendruara plotësisht ndaj njeriut. Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i këtyre zjarreve. Në këtë kuadër këto masa janë.

Masa ligjore , mbrojtja e pyjeve/kullotave rregullohet me ligje dhe akte nënligjore ku mbrojtja e tyre është përgjegjësi e të gjithëve por edhe e pronarëve (bashkisë apo subjekteve private) si edhe subjekteve që i menaxhojnë ato.

Masat edukative , këto janë masa të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerëzve dhe përdoren për të gjithë grup moshat, megjithëse më të përdorurat janë për të rinjtë deri në 18 vjet. Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shkollore , leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletëpalosjeve, internetit, televizionit, etj.

Masa informative- propagandistike , qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si edhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit ne pyll. Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

b. Masa përgatitore.

Duke pasur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret , është e domosdoshme marrja e masave përgatitore. Këto masa kanë një natyrë të përhershme gjatë gjithë vitit dhe përfshihen :

Zbulimi në kohë i zjarrit

Transferimi i Informacionit mbi zjarrin

Organizimi i zjarrfikësve dhe vullnetarëve

Ndërtimi i shtigjeve dhe Brezave mbrojtës kundra zjarrit

Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret.

Zbulimi në kohë i zjarrit është i një rëndësie të madhe për lokalizimin dhe fikjen shpejt të tij. Zonat tona malore kanë një dukshmëri të dobët, me qëllim që zjarri të mund të zbulohet në kohë organizohet shërbimi i monitorimit në terren nga vëzhguesit kundra- zjarr / vrojtuesve

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

kryesisht me patrullim nga toka në periudhën më të rrezikuar të vitit (Sipas VKM nr. 1080/2010 për 5 muaj). E rëndësishme për këtë fazë është që nëpërmjet institucioneve qendrore (ministri/ agjenci etj.) dhe jo vetëm të kryhet monitorimi nga ajri , mbikëqyrje automatike apo elektronike me drona si edhe vëzhgimi satelitor. Masa këto të cilat do të mundësojnë zbulimin dhe monitorimin e këtyre zjarreve.

Transferimi i informacionit mbi zjarrin i kryer në mënyrë të shpejtë dhe ka efektin e dëshiruar. Dhënia e këtij informacioni bëhet nëpërmjet telefonit apo edhe sinjalet e tjera si flamuj etj. Qytetarët të cilët zbulojnë zjarre në pyje/kullota duhet të njoftojnë në nr. e tel 128 Shërbimin Zjarrfikës . Një organizim më i mirë në mënyrën e transferimit të informacionit do të jetë nëpërmjet radiove- lidhëse apo ndërtimit të rrjetit te marrje-dhënie nëpërmjet pajisjeve vëzhguese në të gjithë territorin e mbuluar me pyje.

Organizimi i zjarrfikëseve dhe vullnetarëve deri tek vatra e zjarrit është shumë e rëndësishme për këtë arsye duhet njoftuar menjëherë me zbulimin e zjarrit. Transporti i organizuar i zjarrfikëseve dhe pajisjeve mënyra e organizimit të tyre dhe vullnetarëve krijon premisa për menaxhim të mira të situatës së zjarrit.

Ndërtimi i Shtigjeve ose brezave pyjor , kundra zjarrit shërben si një pozicion mbrojtës për zjarrfikësit por edhe vullnetarët për këtë arsye hendeqet ekzistuese në pyje duhet të jenë gjatë gjithë kohës të pastruar nga materiali djegës . Hapja e hendeqeve dhe dimensionimi i tyre (gjerësia) është e ndryshme në vartësi nga lartësia e pemëve, pjerrësia e terrenit etj. Për shembull nëse pemët janë rreth 20m , gjerësia e hendekut do të jetë minimumi 40cm.

Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret. Bazuar në ligjin Nr.57/2020 "Për Pyjet", ligjin nr. 9693/2007 " Për fondin kullosor" si edhe VKM nr. 1080/2012"Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve", hartohet plani operativ për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

c. Masa direkt

Pavarësisht nga masat më të mira preventive të marra , zjarret përsëri ndodhin. Për këtë arsye nevojiten masat direkt. Këto janë masa të cilat ndërmerren gjatë kohëzgjatjes së zjarrit dhe synojnë lokalizimin dhe shuarjen e tij. Për të lokalizuar apo shuar një zjarr është e nevojshme të largohet një nga elementet nga i ashtuquajturi trekëndësh i Osborn-it. përkatësisht materiali djegës , burimi i nxehtësisë apo oksigjeni.

Sipas asaj se cili material ose mjet përdoret për këtë qëllim , **metodat e shuarjes** ndahen në:

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçe Tel. 0861 2 2026

- **Shuarje e zjarrit me tokë**, metoda më e vjetër e përdorur për këtë qëllim , ku materiali i tokës përdoret si izolator , pra largon elementin oksigjen nga materiali djegës. Toka gjithashtu vepron si një izolant i mxehtësisë , përkatësisht energjia termike për djegien e drurit.



- **Shuarje e zjarrit me ujë**, edhe kjo një nder metodat tradicionale në shuarjen e zjarreve. Veprimi i ujit në procesin e shuarjes është i shumëfishtë.



Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

- **Luftimi i zjarrit me zjarr** , megjithëse duket si konfuze, kjo metodë është efektive por mbart në vetvete rrezik dhe kërkon persona të trajnuar dhe me përvojë. Në vartësi të taktikës për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit, në një distancë të caktuar nga zjarri ndizet një " zjarr i kontrolluar" (që mund të lëvizë në drejtim të kundërt ose të njëjtë me drejtimin e lëvizjes së zjarrit) i cili djeg materialin para frontit të zjarrit , kur zjarri arin në atë sipërfaqe, nuk ka çfarë të djegë dhe zjarri shuhet.



- **Shuarje e zjarrit nga ajri** nëpërmjet aeroplanëve është përdorur për herë të parë në vitin 1930. Në përgjithësi kjo është një metodë uji ose kimikatesh , por për shkak të specifikës është e veçuar si metodë e veçantë. Është metodë mjaft e shpejtë dhe efikase sidomos për rastet e terreneve malore .

- **Shuarja e zjarrit me kimikate** , në këtë rast përdoren kimikate të ndryshme. Kjo metodë alternohet me atë të ujit sepse në përgjithësi këto kimikate shpërbëhen nëpërmjet ujit. Llogaritet se 70% e ujit që përdoret në shuarjen e zjarreve harxhohet pa efektivitet , për këtë arsye ujit i shtohen kimikate të ndryshme të cilat përmirësojnë efektin e shuarjes së zjarrit.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026



- **Shuarje e zjarrit me eksploziv**, përdoret kryesisht si metodë ndihmëse. Kryesisht për të rrezuar pemë, gërmim kanalesh, krijim pengesash etj. Në rastet e shpërthimeve krijohet " re e pluhurit" e cila ul përqindjen e oksigjenit në ajër rrjedhimisht zjarri ul intensitetin ose shuhet plotësisht.



Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

6. Veprimet kryesore gjatë zbulimit të zjarrit në pyje/kullota.

Detyrë qytetare e çdo individi , në rast se zbulon zjarr në pyll/kullotë, është që të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur institucionet përgjegjëse. Nga shpejtësia e informimit, saktësia dhe përmbajtja varet suksesi i aksionit të shuarjes së zjarrit.

Hapat që duhet të ndërmerren janë:

1. Telefononi nr. **128** pa pagesë i Shërbimit Zjarrfikës.
2. Prezantoni veten me emër e mbiemër.
3. Tregoni se ku jeni (vendndodhjen e saktë).
4. Tregoni vendndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orientuese të sakta, me emrin e vendit , vendbanimit më të afërt apo objekte të njohura)
5. Tregoni llojin e bimësisë që po digjet (dru , shkurre , bar, etj.)
6. Nëse vëreni diçka të dyshimtë afër vatrës së zjarrit për shembull automjet mundohuni të shënoni targën apo ta mbani mend.
7. Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin me mjete rrethanore atëherë ndërhyni, në të kundërt largohuni në një distancë te sigurt.
8. Me qëllim që të kuptoheni me personin në telefon jeni të lutur të flisni qartë dhe ngadalë.

Informacioni i dhënë në këtë mënyrë është i saktë dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme , përcaktimi i vatrës së zjarrit, lloji i materialit djegës, nëse zjarri ka qenë i qëllimshëm etj.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel: 0861 2 2026

7. Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor.

Baza Ligjore :

Ligjit nr. 115/2014 **"Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë",**

Ligji nr. 139/2015 "**Për vetëqeverisjen vendore**".

Ligji Nr. 57/2020, "**Për Pyjet**",

Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007: "**Për fondin kullosor**" i ndryshuar.

Ligji Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 "**Për Mbrojtjen e Mjedisit**".

Ligji Nr. 152, datë 21.12. 2015 "**Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi**".

VKM 1080, datë 22.12.2010 **"Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve".**

Përkufizime:

"Rrezik zjarri" është situata e krijuar nga akumulimi i faktorëve që nxitin mundësinë e nisjes së zjarrit dhe zhvillimit të tij.

"Sisteme të diktim-sinjalizimit" janë pajisje që diktojnë, sinjalizojnë shfaqjen e tymit, gazrave dhe zjarrit.

"Shërbimi vullnetar i mbrojtjes nga zjarri" është organizimi i strukturës vullnetare për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, nga organet e njësitë e qeverisjes vendore, nga personat juridikë, që kryejnë veprimtaritë e tyre në Republikën e Shqipërisë, nga institucione dhe agjenci shtetërore, të cilat kanë përgjegjësi për administrimin e pasurive shtetërore me rrezikshmëri nga zjarri.

"Zjarr" është dukuria e djegies, e shoqëruar me nxehtësi të lartë, tym dhe dritë në formë flakësh përcëlluese.

"Zjarr normal" është zjarri që shkakton dëm, për përballimin e të cilit janë të mjaftueshme forcat operacionale, mjetet dhe pajisjet e stacionit zjarrfikës të bashkisë.

"Zjarr masiv" është zjarri që zhvillohet apo tenton të zhvillohet në sipërfaqe e volume të konsiderueshme, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës i një stacioni, kërkohet edhe pjesëmarrja për ndihmë nga stacionet zjarrfikëse të bashkive të tjera.

"Zjarr me përmasa të mëdha" është zjarri që zhvillohet në sipërfaqe e volume të mëdha, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës, kërkohet edhe pjesëmarrja, për ndihmë, e forcave e mjeteve të shërbimeve apo strukturave të tjera operuese.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

"Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtim" është tërësia e masave tekniko-organizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktikave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës.

"Mbrojtja e pyjeve dhe e tokës pyjore" është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pyjeve të burimeve pyjore e jo pyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë.

"Mbrojtja e pyjeve dhe e tokës pyjore" është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pyjeve të burimeve pyjore e jo pyjorë bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë.

Në rast se në fondin pyjor ose në një pjesë pylli dhe në shkurre bie zjarr, organet e shërbimit pyjor, organet e njësive të qeverisjes vendore, çdo subjekt shtetëror a privat, njësi apo repart ushtarak, shkollë, institucion publik e privat, si dhe çdo shtetas kanë detyrë të njoftojnë dhe të marrin pjesë për shuarjen e tij.

Bashkia Maliq me strukturat e saj , Njësitë Administrative , Drejtoria e Shërbimit Pyjor , në zbatim të dispozitave ligjore si më sipër , për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në administrim të saj parashikon marrjen e masave organizative si më poshtë:

-Në rastet e zjarreve në pyje/kullota në territorin e Bashkisë Maliq ngrihet dhe funksionon shtabi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi i cili drejton dhe organizon gjithë veprimtarinë për "Organizimin e ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit". Krijimi i skuadrave Vullnetare ,trajnimi i tyre mbështetja e tyre nga shërbimi pyjor pranë bashkisë Maliq.

-Ky shtab **kryesohet nga Z. Gëzim Topçiu** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Maliq dhe përbëhet nga:

Z. Johand Sulo – Drejtor i Pronave Publike dhe Aseteve, Bashkia Maliq.
Z. Sadik Halili – MZSH Bashkia Maliq.
Z. Klarsen Brako – Përgjegjës Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Arben Hoxha – Kordinator Inspektimi, Sektori Inspektimit.
Z. Niko Xega – Inspektor Kordinues Pune
Z. Petrika Theodhosi – Specialist Sektori i Pyjeve dhe Kullotave.
Z. Niko Demollari – Kordinator Menaxhimi, Sektori Menaxhimit Pyje/Kullota.
Z. Burbuqe Beshiri – Administratore Njësia Libonik.
Z. Kreshnik Azo – Administrator Njësia Pojan.
Z. Fetah Hoxha – Administrator Njësia Moglicë.
Z. Qezar Bezati – Administrator Njësia Vreshtas.
Z. Nazmi Qose – Administrator Njësia Gorë.
Z. Ermal Gjona – Administrator Njësia Pirg.
Z. Rezart Bezhani – Teknik Kordinator Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Artan Fraholli – Teknik Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Artan Petriti – Teknik Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Robert Matraku – Teknik Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Tomorr Belishta – Teknik Pyje/Kullota Bashkia Maliq.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Z. Romeo Koro – Inspektor Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Ergys Skënderi – Inspektor Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Sokol Kellezi – Inspektor Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Donald Beqiraj – Inspektor Pyje/Kullota Bashkia Maliq.

- Pranë Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Maliq ngrihet shtabi i Drejtorisë i cili ka të organizuar sistemin e vrojtim-sinjalizimit me anë të strukturës së Vrojtuesve prej 6 punonjës pylli / zjarri.

- Të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Maliq të organizojnë/riorganizojnë "Shërbimin vullnetar të mbrojtjes nga zjarri" . Këto skuadra përbëhen nga 8-10 anëtarë dhe do të mbahen në eficiencë të plotë nga Njësia Administrative nëpërmjet Teknikëve të Pyjeve . Skuadra e "Shërbimit vullnetar të mbrojtjes nga zjarri" do të jenë strukturat e para që së bashku me strukturat e tjera pyjore do të mbajnë nën kontroll zjarrin deri në mbërritjen e forcave dhe mjeteve që do të organizohen nga Shtabi i Bashkisë Maliq Afati i realizimit : Mars -Prill 2025.

- Struktura "Njësitë Vullnetare për shuarje Zjarri" /teknikët e pyjeve , nëpërmjet Strukturës së Sektorit të Pyjeve dhe MZSH Bashkia Maliq ,do të kualifikohen për mënyrën e shuarjes së zjarrit në pyje/kullota. Afati i realizimit : Prill-Maj 2025.

- Bashkia Maliq nëpërmjet strukturave të saj Sektorit të Shërbimit Pyjor , Emergjencave Civile dhe MZSH, shoqatave të përdoruesve të Pyjeve dhe të kullotave , etj. do të organizojë biseda me komunitetin e zonave Pyjore, nxënësve të shkollave në këto zona mbi sensibilizimin e opinionit për rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve/kullotave : Afati i realizimit: gjatë gjithë vitit.

- Bashkia Maliq nëpërmjet Sektorit të Shërbimit Pyjor do të realizojë Hartën e Zonave të Rrezikuara nga Zjarri për Pyjet/Kullotat në territorin e Bashkisë Maliq. Kjo Hartë do të bëhet publike në të gjitha Njësitë Administrative të cilat kanë zonë pyjore të rrezikuar, shkollat si edhe ambiente të tjera publike. Kjo hartë do ti vihet në dispozicion edhe Emergjencave Civile dhe MZSH. Afati i realizimit: maj 2025.

- Bashkia Maliq nëpërmjet Sektorit të Shërbimit Pyjor do të realizojë Hartën Operative të Mbrojtjes nga Zjarri për Pyjet/Kullotat në territorin e Bashkisë Maliq. Kjo Hartë do të përmbajë të gjithë objektet e ekspozuara nga zjarret , largësitë e tyre nga qendrat e banuara pikat e vrojtim sinjalizimit , rrugët për lëvizjen e mjeteve. Kjo Hartë do të bëhet publike në të gjitha NJ.A. të cilat kanë zonë pyjore të rrezikuar, shkollat si edhe ambiente të tjera publike. Kjo hartë do ti vihet në dispozicion edhe Emergjencave Civile dhe MZSH. Afati i realizimit: maj 2025.
- Bashkia Maliq nëpërmjet Sektorit të Shërbimit Pyjor do të realizojë aktmarrëveshjet me vrojtuesit / sinjalizuesit në parandalimin edhe mbrojtjen e pyjeve/kullotave nga zjarret. Afati i realizimit: maj 2025.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel: 0861 2 2026

- Punonjësit e Sektorit të Shërbimit Pyjor / Teknikët e pyjeve dhe Inspektorët detyrohen të mbajnë takime me Administratorët e NJ.A. , komunitetin , barinjtë në kullota , subjekte të tjera që veprojnë në mjedisin pyjor /kullosor me qëllim ndërgjegjësimin për rëndësinë e pyjeve/kullotave si edhe parandalimin e rënies së zjarreve. Afati i realizimit: gjatë gjithë vitit.

- Të gjitha strukturat e Shërbimit pyjor gjatë periudhës së emergjencës (maj -tetor) të kenë të njohura në çdo moment lëvizjet e punonjësve . Për çdo lëvizje të lihet numri i telefonit celular dhe familjar. Afati i realizimit maj-tetor.

- Vrojtues/sinjalizues, Teknikët e Shërbimit pyjor dhe Inspektorët gjatë periudhës së emergjencës (maj -tetor) do të njoftojnë në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave , 2 herë në ditë ora 8.00 dhe 20.00 mbi situatën në zonën e tyre. Për këto njoftime do të mbahet Libri i Gatishmërisë. Afati i realizimit maj-tetor.

- Sektori i Pyjeve dhe Kullotave çdo të hënë dorëzon pranë Bashkisë Maliq evidencën operative të situatës javore. Afati i realizimit maj-tetor.

- Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore/kullosore , vrojtuesi/sinjalizuesi kryen veprimet si më poshtë:

  1. Njofton menjëherë në numrin e **telefonit 128 Shërbimin Zjarrfikës** dhe **129 të Policisë së Shtetit** ku prezanton veten me emër e mbiemër, tregon se ku jeni (vendndodhjen e saktë), tregon vendndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orientuese të sakta, me emrin e vendit , vendbanimit më të afërt apo objekte te njohura), tregon llojin e bimësisë që po digjet (dru , shkurre , bar, etj.).

  2. Njofton Administratorin e NJ.A. ku ndodhet vatra e zjarrit.

  3. Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin me mjete rrethanore atëherë ndërhyni, në të kundërt largohuni në një distancë te sigurt.

  4. Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore/kullosore , dhe marrjen e njoftimit nga vrojtuesi/sinjalizuesi , Administratori i NJ.A. , kryen veprimet si më poshtë:

  5. Njofton Kryetarin e Bashkisë në pozicionin e Kryetarit të Shtabit ,

  6. Njofton Strukturën "Njësitë Vullnetare për shuarje Zjarri" e cila është ngritur dhe funksionon pranë NJ.A. në fjalë.

  7. Të gjithë bashkë, organizohen për shuarjen e zjarrit ose lokalizimin e tij deri në mbërritjen e forcave të specializuar të mbrojtjes nga zjarri.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

SKEMA E LAJMERIMIT NGA PERSONELI PYJOR NË RAST ZJARRI NË PYJE DHE KULLOTA



Kontakt i Emergjencave Civile
TEL. 128
CEL.0698163651
CEL.0692669950
CEL.0675529928
CEL.0692585559

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë
Tel: 0861 2 2026

- Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi mblidhet në çdo kohë që shihet e arsyeshme nga Kryetari i saj. Në këto mbledhje do të analizojë gjendjen dhe do të përcaktojë masat në vijueshmëri në përputhje me situatat që mund të krijohen. Përgatit dhe publikon komunikatën dhe informacione të tjera të nevojshme në funksion të situatës për punën e bërë në mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave nga zjarret.

- Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në rastet e " zjarreve masive" apo " zjarreve me përmasa të mëdha" sipas situatës që krijohet , i kërkon Institucionit të Prefektit në pozicionin e kryetarit të Shtabit qendror ndihmë për përballimin e situatës.

- Të gjitha strukturat e Bashkisë të cilat janë pjesë e këtij Plani Masash , duhet të përgatitin Programin e Detajuar për marrjen e masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri. Afati i realizimit maj 2025.

Ky program masash është hartuar sipas materialeve të Agjencisë për Mbështetjen e Veteqeverisjes Vendore vënë në dispozicion nga nënshkrimi i Memorandumit për marrëveshjen e bashkëpunimit të Bashkisë Maliq me Bashkinë e Hasit për replikimin e praktikës në fushën e mbrojtjes civile: Ngritja e grupeve vullnetare për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret (Konkursi Praktika të Mira 2020).

Përgatiti :

Përgjegjës Sektori Sektori i Pyje / Kullota	**Drejtor i Pronave Publike dhe Aseteve**	**Specialist Ing. Pyjesh Sektori i Pyje / Kullota**
Klarsen Brako	Johand Sulo	Petrika Theodhosi

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
K. BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026